I.

# Rrusárî

# i Zonjës Vírgjërë

**Parkalesî Isu Krishtit n' Sakramént**

E

**Parkalesî për të vdekurit**

PALERMË
te Shtipëshkronja " Pontificia "
1931

# ABETARI

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | a | *a-ra.* | 8. | i | *i-ja.* | 15. | p | *p-ak.* |
| 2. | b | *b-esa.* | 9. | j | *j-emi.* | 16. | r | *r-aar.* |
| 3. | d | *d-era.* | 10. | h | *k-emi.* | 17. | s | *s-iu.* |
| 4. | e | *e-ja.* | 11. | l | *l-ule.* | 18. | t | *t-rimi.* |
| 5. | f | *f-are.* | 12. | m | *m-ori.* | 19. | u | *u-rata.* |
| 6. | g | *g-uri.* | 13. | n | *n-una.* | 20. | v | *v-iti.* |
| 7. | h | *h-era.* | 14. | o | *o-ree.* | 29. | y | *syy.* |
| | | | 22. | z | *z-oti.* | | | |

ë *mëma.* ë *ditët.*

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| dh | *dh-ezur.* | ds | *ds-ani* | dç | *dç-esh.* |
| th | *th-omi.* | ts | *ts-opa.* | tç | *tç-aita.* |
| sh | *sh-eshi.* | nj | *nj-eriu.* | lj | *lj-epur.* |
| gh | *gh-ojee.* | gj | *gj-inde.* | kj | *kj-eni.* |
| ll | *ll-ojee.* | rr | *rr-oni.* | hj | *hj-eja.* |
| | | zç | *go-zç-da.* | | |

Con approvazione ecclesiastica
Ottobre 1931



O Zonja e Parraisit, na tek Ti vijëm e kuturisemi. Gjith shpresën t' ënë e kemi tek Ti. Ti na ruan nën shpágarit t'ënt, o Mëmëza e jonë.

## Lutëje Shën Mërîs Odhigjítrie

Të kujtónesh, o lipisiarëja zonjëzë Odhigjítrie, se ti jê burími i pashterrëshëm i hírevet, jó vétëm për nê, po për gjithë bijëzit e tû, çë rëkójën te këjó gropë lotësh. Gjegje me tê mirë lutëjen çë na, me bésë vijëm é të vëm përpara në këmbë të thrónit, sâ ti t'e përeç me të bút, tue na fituar nga Isúthi i jît hirin çë akjë na dúhet.

Shtóna Ti besën, shpërésën é dashurîn. Bën ti sâ jeta e jonë të jêt e sbukurúarë me vépëra të mira, të çilat kánë akjë vëlésë é rëndësî përpara thrónit t'atîj Gjikjtári të hierúashëm, çë një ditë kâ të na gjikonjë, fjála e t'çilit isht e pathieshme. Uj mbí nê sizit e tû lipisiarë, ashtú si një herë i úje mbi atá çë të lúteshin te dásmat në Kanë.

Mê se më falna sót hirin *(këtu lipet hiri çë dishirónet)*. Për tîj isht púnë e léhtë të na gëzosh, përsé ti kê fukjî é pushtét të máth përpara Isúthit t' ënt. Digjó, o Mëme lutëjen t'ënë të përújëshme, si ná po të fálemi me Ëngjëllin : T'fálem o Mëri !

## PREGHIERA

### per ottenere qualunque grazia dalla Madonna Odigitria

*Ricordatevi, o piissima Maria Odigitria, che voi siete la fonte inesauribile delle grazie, non solamente per noi, ma per tutti i vostri figli, che gemono in questa valle di pianto. Ascoltate benigna la nostra preghiera, che fiduciosi veniamo a deporre a piè del vostro trono, perchè l'ascoltiate, impetrandoci dal vostro Gesù la grazia della quale abbiamo tanto bisogno. Dateci un aumento di fede, di speranza e di carità. Fate che la nostra vita sia ingemmata di opere buone, che hanno tanto valore*

*dinanzi al trono di quel Giudice inappellabile, che un giorno ci dovrà giudicare. Volgete su noi i vostri occhi misericordiosi, come un giorno li volgeste ai poveri sposi di Cana.*

*Concedeteci in modo speciale* (si domanda la grazia desiderata). *A voi nulla costa l'esaudirci, perchè siete così potente presso il vostro Gesù. Ascoltate, o Madre, la nostra umile preghiera, mentre vi salutiamo con l'Angelo: Ave Maria!*

---

*Te Mëma e t'Lártit gjíthë nanì po t'hjídhemi, nà fajtórë edhè të mjérë i perújemi, ngâ thélpi i zëmbrës po tue thírrë asâj në pendím: Zónjëzë e përmáhshëme, na jíp ndíhmën t'ënde, shpéjt, sè jémi è sbíremi për lusmën e mëkátëvet. Mòs lè pâ-hîr t'dhënët e tû, sè tîj shprésë nà kémi t'vétëme.*



IL MIRACOLOSO QUADRO

DELLA

# MADONNA ODIGITRIA

AUGUSTA PATRONA

DI PIANA DEI GRECI

## Rrusárî i shën Mërîs

Ndë embër të Jatit, të Birit, të Shpirtit Sheit. Ashtú kloft.

Patçe për mua lipisíi, o i madh' in' Zot! U ndíenj pendím, o i larti Perêndíi, dhëmbem é helmonem me gjithë zëmbërë për gjith' mëkatët tçë kam buur te gjella e jime. Helmonem, se kam sbiérrë Parraisin é më nget Pisa; po mê shumë më dhëmp zëmbëra, se, tue mëkatrúar, kam ftesur Tîj, i madh'in' Zot, tçë jê gjith' e mira é tçë ka' dua mirë mbi gjith' shërbiset.

U të taks me të vërtetë, me ndihmën t'ënde, të mos t'ftes mê me mëkatën t'ime. Vdeksha mê mirë! Po të dafsha mirë é të shërbefsha Tîj, i madh' in' Zot, i mirë é i ftet é klofsha me tîj per gjith-monë.

O Zonja Vírgjërë e shën Mërî, dua sot të thom rrusárîn sheit, é të truhem fort mos më lipset kúrr lipisia e t'in Zoti.

## Misteret e gezimëvet

*(tek e hënia é tek e íntia)*

1. Nga Parraisi një i dërgúar
pruri fialën për të rruar
é kûr uji kriet Mëria
te ajó zuri Perëndia.
Zonjë e madhe kam harê
përsé ti e gëzúame jê.

Ati i jinë tçë jet ndë kjiell, sheitrúar kloft embri i jit, arthët rregjëria e jote, u bëft vullimi i jit, si ndë kjiell ashtú ndë dhê. — Bukën t'ënë të përdítçëmen ëna neve sot, ndëjéna dëtirët t'ona, ashtú si edhé ná ja ndëjejëm të dëtërúamëvet t'anë, è mos na le të biem ndë ngárie, po lirona nga i ligu. Ashtú kloft.

Falem, Mërii, e hîr-plota, in'Zot ê me tîj. Bekuarê ti jê mbi gjithë grât, é bekúarë pema e gjirit t' ënt Isuthi. E shë Mërii, Mëma e t' in' Zoti, parkalés për

nê, të mëkatrúamit, naní é te hera e vdékies t'ënê. Ashtú kloft. *(Dhiét herè).*

Vëldíi past'Ati, Biri, Shpirti Sheit naní edhé për gjith-monë mbë jetë të jétëvet. Ashtú kloft.

2. Vate prân te Lisabeta
Zonja Vírgiërë, é te jeta
ng'ish shën-Janji, po u gëzúa
é te gjiri u sheitërúa.
Zonjë e madhe...

*Ati i jinë... Falem, Mèrî... (10 herë) Vëldî...*

3. Mbi tsa kashtë é te një shpellë,
kûr ish nata shumë e thellë,
u lê diali i krietarit
ndërmés kaut edhé gomarit.
Zonjë e madhe...

*Ati i jinè... Falem, Mërî... (10 herè) Vèldî...*

4. Si gjith' t' iérazit faitore,
Virgjëresha ndë faltore
me të prunjur, mori e shkoi
é t'in' Zoti ja dhurói.
Zonjë e madhe...

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë) Vëldî past...*

5. Kûr i larti Bîr u sbuar,
vêj shën-Mbriza tue kërkúar;
mbi tri ditë te kjiteti
ndër të díturit e gjeti.
Zonjë e madhe...

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë)*
*Vëldî...*

## Misteret e hélmevet

*(tek e mártia é tek e prëmptia)*

Brënda kopshtit parkalés
I Pâ-vdekti é ndíen se vdes;
psherëtín tue dirsur gjak,
sâ me atë gjith trolli u lak.
O e helmúara e shën Mërî,
Bashk me tîj ú jam ndë zî.

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë)*
*Vëldî...*

2. Si një kjenkjëth e rrëmbíen
e pushtijtin, e shkarzíen;
me shkupínj e vrân é e sosën,
gjith e murrën é e lavosën.
O e helmúara...

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë)*
*Vëldî...*

3. Mbret i falur për të kjeshur
me një tsopë t'kukje i veshur
miû [illegible] bash një kurorë
é për shkop një kallm në dorë.
O e helmúara..:

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë)*
*Vëldî...*

4. E gjikúan si një kusâr,
si një vrasës për të vrâr;
kush e nëm é kush e rrahë,
kush e shân me krikjen n'grahë.
O e helmúara...

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë)*
*Vëldî...*

5. Te ajó krikje e miera e jëmë,
si e kjëllúarë nga një gjëmë,
të varrúar, me mishtë shkjerrë,
sheh të bírëthin të viérrë.
O e helmúara...

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë)*
*Vëldî...*

3. Mbret i falur për të kjeshur
me një tsopë t'kukje i veshur
miû [illegible] bash një kurorë
é për shkop një kallm në dorë.
O e helmúara..:

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë)*
*Vëldî...*

4. E gjikúan si një kusâr,
si një vrasës për të vrâr;
kush e nëm é kush e rrahë,
kush e shân me krikjen n'grahë.
O e helmúara...

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë)*
*Vëldî...*

5. Te ajó krikje e miera e jëmë,
si e kjëllúarë nga një gjëmë,
të varrúar, me mishtë shkjerrë,
sheh të bírëthin të viérrë.
O e helmúara...

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë)*
*Vëldî...*

## Misteret e veldivet

*(tek e mërkúria, tek e shtúnia é tek e díellia)*

1. Si një trim tç'u sgjua nga gjumi,
mbi trî dit'u ngjâll i lumi.
Vate é Príndërat liròi,
é nga i ligu na shpëtói.
Zonjë e lume e shën Mërî,
bashk me tîj ú bënj haidhî.

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë)*
*Vëldî...*

2. Mundësôr, mbi dizét ditë,
te Parraisi Krishti u ngjit,
i përitur me lëvdî,
me këndime é me haidhî.
Zonjë e lume...

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë)*
*Vëldî past...*

3. Ndë të lutur, shën Mëria
rrîj me Apóstojit te shpia;
Shpirti Sheit i táksur erdhi,
é mbi 'tá të mirat derdhi.
Zonjë e lume...

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë)*
*Vëldî*

## Misteret e veldivet

*(tek e mërkúria, tek e shtúnia é tek e díellia)*

1. Si një trim tç'u sgjua nga gjumi,
mbi trî dit'u ngjâll i lumi.
Vate é Príndërat liróji,
é nga i ligu na shpëtói.
Zonjë e lume e shën Mërî,
bashk me tîj ú bënj haidhî.

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë)*
*Vëldî...*

2. Mundësôr, mbi dizét ditë,
te Parraisi Krishti u ngjit,
i përitur me lëvdî,
me këndime é me haidhî.
Zonjë e lume...

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë)*
*Vëldî past...*

3. Ndë të lutur, shën Mëria
rrîj me Apóstojit te shpia;
Shpirti Sheit i táksur erdhi,
é mbi 'tá të mirat derdhi.
Zonjë e lume...

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë)*
*Vëldî*

4. Kûr arruri dita e thënë,
la e bekúamia jetën t'ënë;
te Parraisi in' Zot e ftoi,
me gjith kurmin fluturói.
Zonjë e lume...

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë) Vëldî...*

5. Mbretëresha ajó ndë kjiell
throni i 'sâj shkëlkjén si díell
ësht hareja e Faremirit,
nuse, mëmë é bijë e t' Birit.
Zonjë e lume...

*Ati i jinë... Falem, Mërî... (10 herë) Vëldî...* Salve Regina

Na të fálemi, o Perëndeshë, Mëmëza e jonë gjith-lipisî, gjella, ëmbëlsia, shpresa e jonë. Ná të fálemi. Tîj të thërésiëm ná të shkretit bij t'Evës. Mbi tîj, o Mëme, pshërtojëm, tue rëkúar é tue klâr te kjo jetë e plotë me lotë. Andái ti, e shë-Mbrizë, ndihma e jonë, prîr-mbi nê sît t'at me lipisî é, si sos kjo jetë e shkretë, ti dëftona pemën e gjirit t'ënt, Isuthin. Se ti jê e butë, e tëmbël, gjithlipisî., o Zonja Vírgjërë e shë-Mërî. Ashtú kloft.

## Parkalesî t'in'Zoti

Ná t'bíem prëmíst, i madh'in'Zot, é të lútemi me gjithë zëmbërë; Të trúajëm fort Klishën sheite, tçë Ti stise në jetë, é Papën sheit, tçë Ti vure më vent t'ënt. Klisha e jote katólike po klofshit mundësore mbi gjithë të ligat é mbi gjithë errësirat edhé eresît. Mos të klofshin kûrr ndaitur bijt t'at, o i madh'in'Zot, po klofshit pakjëja e jote ndër gjithë kombet te jeta, tçë Ti shpërbleve me gjakun t'ënt, akjë të shtreit. U njomshin zëmbrat e të mëkatrúamëvet é gjetçin tek Ti lipisî. Të trúajëm, o Zoti Krisht, gjinden t'ënë të arbëreshë, ku do ndodhen edhé janë. Ti jipi dritën të t' njóhëjën, hiret é bekimet sâ të t'shërbejën, sâ të t'dên mirë. Të trúajëm gjërîn t'ënë, mikjt, armíkjt é gjith njerî, tçë na truhen te parkalesia. - Rrusárî sheit tçë jemi é thomi, vafshít edhé për shpírtërat tçë janë te Purgatórî.

Sâ të kemi Ndëjesat sheite, parkalésiëm, si do Klisha sheite, tue thënë: *Ati i jinë... Falem, Mërî... Vëldî past...*

# Litania e shën Mërîs

Kjirie eléison.
Hriste eléison.
Kjirie eléison.
Gjégjëna, o Zoti Krisht,
Gjégjëna, o Krisht, gjégjëna.
At i kjíelliës in' Zot, Lipisî për nê
Bîr, shpërblês i dheut in'Zot, »
Shpîrt i Sheit in' Zot, »
Shéitia Trinî, një i vetm'in'Zot, »
E shën Mërî,
Shéitia mëmë e t' in' Zoti,
Shéitia Vírgjër' e Vírgjëravet,
Mëma e Krishtit,
Mëma e të hjuinushmit hîr,
Mëmë e dëlirë,
Mëmë e ndêrshme,
Mëmë e pâ-ngarë,
Mëmë e pâ-ftesme,
Mëmë e dáshurë,

Parkalés për nê (*)

---

(*) Për të vdekurit thuhet : Parkalës për atá.

Mëmë famasore,
Mëma e këshillit i mirë,
Mëma e Stisorit,
Mëma e Shelbúesit,
Vírgjërë e prënoreme,
Vírgjërë e përfálurë,
Vírgjërë e vëldúashme,
Vírgjërë e pushtetshme,
Vírgjërë lipisiare,
Vírgjërë e besme,
Paskjira e ligjës,
Throni i urtësîs,
Kroi i harês t'ënë,
Putçêr shpirtulôr,
Putçêr i prëndêrm,
Putçêr i ndritëm i të lúturit,
Trundafile e mistike,
Pirgjë e Davidit,
Pirgjë e éburtë,
Shpia e ârtë,
Arka e dhiátës,
Dera e kjíelliës,

**Parkalés për nê (*)**

(*) Për të vdekurit thuhet : Parkalés për atá.

Illi i menatës,
Shëndétia e të sëmúrëvet,
Pështrimi i të mëkatrúamvet,
Gëzimi i të helmúamvet,
Ndihma e të krështérëvet,
Perëndesha e Ëngjëjvet,
Perëndesha e Patriárkravet,
Perëndesha e Profétravet,
Perëndesha e Apóstoivet,
Perëndesha e Mártravet,
Perëndesha e Skomollervet,
Perëndesha e Vírgjëravet,
Perëndesha e gjithë Shéitravet,
Perëndeshë tçë zure pâ e ngarë nga faji i pâr,
Perëndesha e Rrusárît sheit,
Shën Mbëriza Odhijitre,

**Parkalés për nê (*)**

Kjenkji i t' in' Zoti, tçë mëkatët e jetës ndsíer. – Ndëjena, o i madh'in' Zot.
Kjenkji i t' in' Zoti, tçë mëkatët e jetës ndsíer. – Gjégjëna, o i madh' in' Zot.
Kjenkji i t' in' Zoti, tçë mëkatët e jetës ndsíer. – Lipisî për nê.

(*) Për të vdekurit thuhet: Parkalés për atá.

Ù t' falem, Perëndeshë,
tçë jê mëmëza e jonë.
é tçë sivás t'ën' Zonë
të vemi n' kjíell,
Gaze é harê ti síell,
kûj ndodhet në hjidhî,
é kûj me shpresë rrî
shpresë i dhurón.

Të thret é të kërkón
kjo zëmbrë e ngarrafosme
tç' ëë gjith' e farmakosme
é në skurî.
Zonja Virgjrë e shë-Mbrî,
me at' sî, tçë t'llambarís,
gjith' jetën e lipís:
ti vurna 'rê.

Priru é bënëna hjê,
me shpagrin t'ënt pështrona,
é birin t'ënt dëftona
në jet' tçë nk' sos.
Mos e mirr me kopós,
Mëma Virgjrë e shë-Mbrî,
mirre me lipisî
ktë kënkëzë sheit.

Gjegjena të miérët shpeit
në ktë t'érrur' jet',
tek ajó jétëzë e ftet
ëna Parraisin.

U kam besë te Perëndia, Ati i gjith-mëndëmi, tçë buri kjíelliën é dheun.-Edhé te Iesu-Krishti, i Biri i 'tîj i vétëmi, Zot i jinë. I tçili zuri pait Shptrtit Sheit é leu nga Vírgjëra e shë Mbërî. Durói nën Pontsëj-Pilatit kle vunë ngrikj, vdikj é kle varrëzúar. U sdrip te Pisa; të tretën ditë u ngjâll së vdékurit. U ngjip te kjíellia é rrî te ana e dreitë e t' Jatit, të gjith-mëndëmit Perëndî. Andéi kâ të vinjë pameta të bënjë ligjë mbi të gjallët é mbi të vdékurit.

U kam besë te Shpirti Sheit, te klisha sheite katólike, te shokëria e shéitravet, te ndëjesa e mëkátëvet, te të ngjâllurit e kurmit, te jeta e pâsosme. Ashtú kloft.


Ω
O N

## Zotit Krisht në Sakramént

Krishti jim, i Madh'in' Zot, çë për nê rrî nat' e ditë i fshehur në Sakramént, gjith' lipisî é dashurî, tue pritur é tue thritur gjithë sâ vijën të t' gjejën, u kam besë se Ti jê me shpirt, me kurm é me hjuinî te kî Sakramént, u Të proskjinís é Të haristîs për gjithë hiret çë më kê bûr, é më shumë se na u kê dhënë te kî Sakramént, se më kê dhënë për pajtore Mëmën t'ënde e Shën Mërî é sé më kê thritur te kjo Klishë. U i falem sot é i lutem Zëmbrës t' ënde plot-dashurî é e haristís për ktë dhurëtî të madhe; u dua të t'jap ndo shpërblím për gjithë ftesat é të sharat e armikjevet t' atë në Sakramént é dua të t' jap proskjinîn çë Të nget te gjithë jeta ku rrî i fshehur në Sakramént i harruar é i pâ-lutur nga njerëzit. Jesui jim, u Të dua mirë me

gjithë zëmbrën t'ime. U ndienj pendím të math se disâ herë kam ftesur miresîn t'ënde të pâsosme. U bënj bê se me fukjîn t'ënde ngë Të ftes më për sâ rronj; é sé naní, ashtú i mjêr é i shkret si jam, u të vuhem te duart t' ote, Të jap é Të dhuronj gjithë vullímin t'im, gjithë ndienjat, dishirimet é shërbiset t'ime.

Çë sot é para Ti bën çë do mbi mua é mbi shërbiset t'ime. Vetëm Të lip é dua dashurîn t'ënde shejte, të kêm durím njera te hera e sprasme é të bënj kurdoherë vullimin t'ënt shejt.

Të truanj gjithë shpirtrat çë janë te Purgatorî é më shumë atá çë te gjella klenë më të divotshim për treshejtin Sakramént é për gjithëshejten Shën Mërî, Të truanj edhé të mjerët të mëkatruamë. U vû, o i Shelbuesi jim, gjithë ndienjat é dashurît t'ime bashk me ndienjat é dashurît të Zëmbrës t'ënde të përmallshme é ashtú të bashkuara ja fal Atit t'ënt të Pasosm é e parkalés në embër t'ent sâ, për dashurîn t'ënde t'i presënjë mirë e t'i marrënjë vesh. Ashtú kloft.



## Kungimi shpirtullor

Jesui jim, u kam besë sé Ti jê në Sakramént. Të dua mbi gjithë shërbiset e jetës é Të dishironj te zëmbra jime. Porsani naní ngë mënt të kungonem me Kurmin é me Gjakun shejt, eja edhé shpirtërísht te zëmbra jime. U Të shtrëngonj të shpirti jimë sikurse ke jardhur

në Sakramént é rrî bashk me Tij: Mos më lé, o i Madh' in' Zot, të ndahem kûr é po kûr ngah Ti. Ashtú kloft.

## Lutie Zotit Krisht si dajëm nga Klisha

Isht é kjaset nata, o i Madh'in' Zot, é të më t'errtit zê fîll të shtronet mbi dhê; arrû hera, o Isúth, të ndahem ngah Ti é të Të lë, o i dashuri jim.

O Isúth çë bekove ditën e sotme, o Isú çë burove é më kjose me hiret t'atë shpirtin t' im! Si Apostojit mbi malin e Taborrit u deja të ngrëja ktú tendëzën t'ime.

Çë shërbés i t'ëmbel isht të prënje sizit t'imë é zëmbrën t'ime mbi Tabernakullin t'ënt. Isht mirë shumë të parkalés é të klâ si edhé të gzonem ketú të këmbët t'ote.

Si tufat e Ëngjejvet pâ u lodhur Të proskjinisen é Të lëvdojën, edhé shpirti jim përsbashku me dashurî të pashuashme Të lëvdón é Të haristís.

Ëj u Të dua mirë, o Perendî, Të dua

fort mirë! é tue u ndajtur ngah Ti, te duart t'ote Të lë zëmbrën t'ime.

Po përçë ngë jam u e vogla llëmpë çë dhizet nd'anëzë Tij gjith'natën? Përçé ngë i glas lulevet çë mblojen me bukurë erë shpizën t'ënde, é veshken é josen dalë e dalë përpara Tij? Ëngjëj çë rrini këtú përpara, thoniji Isuthit se dishiroja sâ zëmbra jime mos të tsitej kûr të rrîj gjith' natën sgjuarë për Atë.

Të falem o Zoti jim i dashuri, jam é vete po më përpara ëm bekimin t'ënt, ruajëm nga gjith' armikjt e shpirtit të padukurë.

Te duart t'ote, o i Mirë, u truanj shpirtin t'im. Ruaje naní é për gjithë monë.

Ashtú kloft.

## Te Bekimi

Artos sárks utos iparhji - alithós Iisù Hrísté mu - os aftós tis mathités su - epinjilon utos legon: - pandes lávete to soma - kjè to éma mu omíos. - Si gar ipas, o Xristè mu - pas o trógon mu tin sarka—

pinon dhe mu kjè to éma - en emí men utos meni, én aftò dh' ego tinhano.

Këjò búkë ë mish të vet,
Zoti Krisht, me të vërtétë;
po si Apóstojit në dhê
dzûn prej teje, kûr i thê:
Kúrmin t'im pa mirrni t'hani
é t' m' e pîni gjakun dzani.
E thê vèt: ô Krishti i jím:
Kush po hâ prej mishit t'im,
kush prej gjakut t'ím po pî,
u n' atë é tek u ai rrî.

*Questo Pane è veramente carne, o Gesù Cristo, come tu stesso annunziasti ai tuoi discepoli così dicendo: Tutti prendete del mio corpo, e del mio sangue egualmente. Imperocchè tu, o Cristo mio, dicesti: chi mangia la mia carne e beve il mio sangue, costui veramente sta in me, ed io sto in lui.*

# Akoluthia dei morti

## Për të vdekurit

Metà pnevmáton dhikjéon tetelioménon – tàs psihás tôn dhúlon (1) su, Soter, anápavson, – filatton aftás (2) is tin makarían zoín, tin pará su, – filánthrope.

*Con le anime dei giusti morti, o Salvatore, concedi il riposo alle anime dei tuoi servi, introducendole nella vita beata presso di te, o amante degli uomini.*

Is tîn katápavsín su, Kjírie, – ópu pándes i Ajií su anapávonde – anápavson kjè tàs psihàs tôn dhúlon (1) su, – óti mónos ipárhjis athánatos.

---

(1) Për një burrë thuhet: *tìn psihjin tu dhúlu su;* për një grua: *tìn psihjìn tîs dhúlis su.*

(2) Për një: *aftín.*

*Concedi, o Signore, il riposo alle anime dei tuoi servi nella tua beata sede, dove tutti i tuoi Santi riposano, poichè tu solo sei immortale.*

Dhoksa Patrí....

Sì î o Theòs imòn o katavàs is Adhin, - kjè tàs odhínas lísas tôn pepedhiménon, - Aftòs kje tas psihàs tôn dhúlon (1) su, Sóter, anápavson.

*Tu sei quel Dio che discendesti al Limbo e liberasti dalle pene i prigionieri, Tu stesso, o Salvatore, concedi il riposo anche alle anime dei tuoi servi.*

Kjè nìn....

I moni agnì kjè áhrandos Parthénos, - i Theòn aspóros kjiísasa, - presveve tu sothíne tàs psihàs tôn dhúlon (1) su.

*Tu sola pura e immacolata Vergine che per virtù dello Spirito Sauto concepisti Dio, intercedi per la salvezza delle anime dei tuoi servi.*

---

(1) Për një burrë thuhet : *tìn psihjìn tu dhúlu su;* për një grua : *tìn psihjìn tîs dhúlis su.*

Evlojitòs î, Kjirie, dhidhahsón me tà dhikjeomatá su.

Anapavson, - o Theòs, tùs dhúlus su, - kjè katátakson aftùs en Paradhiso, - ópu horì tôn Ajíon, Kjirie, - kjè i dhíkjei - eklámpsusin os fostíres, - tus kjekjiiménus dhúlus su anápavson, - parorôn aftón panda ta englímata.

*Concedi, o Dio, il riposo ai tuoi servi e accoglili in Paradiso, dove, o Signore, i cori dei santi e i giusti risplendono come luminari, dà riposo ai defunti tuoi servi, perdonando loro tutte le colpe.*

Alliluia, Alliluia, Alliluia. Makárî ùs ekselékso, kjè proselávu, kjirie, kjè tò mnimósinon aftôn is jeneàn kjè jeneán. Alliluia....

*Beati coloro che hai scelto e accolto, Signore, e la loro memoria di generazione in generazione.*

## Te Mesha

O váthi sofías filanthrópos – pánda ikonomôn, – kjè tò simféron pásin aponémon, – móne Dhimiurjè, – anápavson, kjírie, – tàs psihàs tôn dhúlon su; – en si gar tin elpídha anéthento – tô piitì kjè plásti kjè Theò imôn.

*O solo Creatore, che con profonda sapienza e amore governi l'universo e a tutte le creature dài quel che loro si deve, concedi, o Signore, riposo alle anime dei tuoi servi poichè essi in te, Creatore e Dio nostro, hanno riposta la loro speranza.*

Anápavson, kjírie, tàs psihàs tôn kjekjimiménon orthodhókson hristianòn en topo ajio kjè hóra dhikjéon, psihàs proselávu, Sóter anàpafson.

*Dà riposo, Signore, alle anime dei defunti cristiani ortodossi in luogo santo, e nella città dei giusti accogli le anime loro, Salvatore, e dà riposo.*

Metà tòn ajíon anápavson, Hristé, - tàs psihàs tôn dhúlon su, - entha uk ésti pònos, - u lípi, u stenagmòs, - allà zoì ateléftitos.

*Coi tuoi santi dà riposo, o Cristo, alle anime dei tuoi servi ove non vi è travaglio, non tristezza, non gemito, ma vita imperitura.*

Se kjè tihos - kjè limena éhomen, - kjè présvin evpsósdhekton - pròs òn étekjes Theòn. - Theotòkje animfevte, - tòn pistòn i sotiría.

*Te, Vergine Immacolata, abbiamo quale fortezza e porto e interceditrice accetta presso quel Dio cui partoristi Tu salute dei fedeli.*

## Për Shpirtrat e Purgatorit

Parkalesiëm për shpirtrat e mirë
Çë te ziarri me pakje durojën
É çë presiën ndër lot' me dëshirë
Te Parraisi të shkojën në gzìm.

Zoti Krisht, nà të thomi për dita,
Iipi ndiesën Ti prëhien dhurói;
Te ku mblen e pashuashëmë drita
Pë gjith monë atá klofshin të lumë.

Atà shpirtra t' ën' Zon' dishirojën,
Perëndîn atà thresiën gjith-herët,
Perëndîn atà vetëm kërkojën
Te Parraisi do t'gjejën pushím.

Po sâ riejën se ng' shohiën t' ën' Zonë,
Sâ shërtime nga zëmbrat i dajën;
Nat' e ditë pa u lodhur po thonë :
Shuana, Zot, ktë të math dishirím.

Gjërî e mikj çë te jeta' dhe rroni,
Thonë atá ndër mundimet e zjarrit,
Motra e vllezër mos jú të harroni
Se nà presiëm ngak jú ngushullím.

Ngushullím é dhrosî ngak na presiën
Nga t'Krështerët, nga Klisha e t'in'Zoti,
Ngushullímin, dhrosîn atá shpresiën
Njer të kên të pasosmin trashgím.

---

Kloft kujtimi 'i tire i përjetëshëmë, edhé ndieji, o Zot. Ashtú klóft.

# INDICE

Lutje Shën Mërîs Odhigjitrie . . . Pag. 5
Preghiera per ottenere qualunque grazia dalla Madonna Odigitria . . . . . „ 6
Rrusarî ì Shën Mërîs . . . . . . „ 9
Litania . . . . . . . . . „ 17
Zotit Krisht në Sakramént . . . . „ 23
Kungimi shpirtullôr . . . . . . „ 25
Lutje Zotit Krisht . . . . . . „ 26
Te bekimi . . . . . . . . „ 27
Akoluthia dei morti . . . . . . „ 29
Për Shpirtrat e Purgatorit . . . . „ 33